



Pranimar / Dorezuar Prilijena / Prilijato Received / Dohva ty	20.04	2021	1	viti god year
Organ / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtetes Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM8HCK	1902/2021		1/5	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.136/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.136/2021 të datës 12.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Kadri Zeka", p.n. nga Komuna e Ferizajt, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, respektivisht kundër organit të punësimit-Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve të punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa A.nr.136/2021 e datës 12.03.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. **ANULOHET** Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës per vitin 2020, i datës 08.02.2021 për ankuesin
- III. **DETYROHET** Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Operacione pranë Administratës Tatimore të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi, duke bërë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- IV. **OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, që të ndërmarr veprimet që zbatimi i këtij vendimi të bëhet në si pikën III të dispozitivit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas akt emërimit Nr.11/02/135/09 të datës 05.05.2017 është i punësuar në pozitën e punës "Drejtor", në Drejtorin e Drejtorisë Rajonale, në Departamentin Shtylla Funksionale Operacionet, në Administratën Tatimore të Kosovës në Ferizaj.

Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Operacione pranë Administratës Tatimore të Kosovës, me datën 08.02.2021, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin duke e vlerësuar me notën e përgjithshme (2.37).

Ankuesi, kundër vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2020, me datën 12.03.2021 ka parashtruar ankesën me nr.prot: 1124/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që vlerësimi i rezultateve në punës është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore, pa pasur asnjë njoftim për takim paraprak lidhur me vlerësimin e arritjes së objektivave gjatë vitit 2020, po ashtu pretendon se përkundër që ka qenë një vit me pandemi dhe me reduktim të stafit, është punuar në aktivitete operative dhe madje janë tejkaluar edhe planifikimet e bëra sipas planit të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, komfor dispozitave ligjore në fuqi me datën 23.03.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa me datën 26.03.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër të protokollit 1124/2021 të datës 12.03.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-maili zyrtar i datës 12.02.2021; E-maili zyrtar i datës 10.02.2021; Plani i kontroleve për vitin 2020 dhe realizimi 2019; Plani i vizitave dhe aktiviteteve për vitin 2020 dhe plani 2019; Raport i përgjithshëm statistikor i kontroleve tatimore sipas regjionit janar-dhjetor 2020; Raport vjetor 2020 mbi vizitat permbushese per periudhën janar-dhjetor 2020; Raport i përgjithshëm statistikor i vizitave sipas regjionit janar-dhjetor 2020; Ankesë e ankuesit e datës 10.03.2021; Kërkesa për përgjigje ne ankesë e datës 23.03.2021, nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 26.03.2021 nga Administrata Tatimore e Kosovës; Formulari për planin individual të punës për periudhën janar-dhjetor të vitit 2020; Akt emërim i ankuesit i datës 05.05.2017; Formulari për përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; E-maili zyrtar i datës 29.04.2020; E-maili zyrtar i datës 24.01.2020; E-maili zyrtar i datës 30.12.2019; E-maili zyrtar i datës 14.01.2020; E-maili zyrtar i datës 10.01.2020; E-maili zyrtar i datës 16.12.2019; E-maili zyrtar i datës 24.01.2020; E-maili zyrtar i datës 28.01.2020; E-maili zyrtar i datës 20.09.2019; E-maili zyrtar i datës 03.02.2020; E-maili zyrtar i datës 07.02.2020; E-maili zyrtar i datës 20.02.2020; E-maili zyrtar i datës 28.02.2020; E-maili zyrtar i datës 02.03.2020; E-maili zyrtar i datës 06.03.2020; E-maili zyrtar i datës 05.03.2020; E-mailat zyrtar të datës 12.03.2020; E-mailat zyrtar të datës 13.03.2020; E-maili zyrtar i datës 20.03.2020; E-mailit zyrtar të datës 15.04.2020; E-maili zyrtar i datës 30.04.2020; E-maili zyrtar i datës 19.05.2020; E-maili zyrtar i datës 01.07.2020; E-maili zyrtar i datës 08.06.2020; E-maili zyrtar i datës 03.07.2020; E-maili zyrtar i datës 06.07.2020; E-maili zyrtar i datës 15.07.2020; E-maili zyrtar i datës 22.07.2020; E-maili zyrtar i datës 03.08.2020; E-

maili zyrtar i datës 04.08.2020; E-maili zyrtar i datës 05.08.2020; Raporti analitik i vizitave per PEF per periudhën kohore 21.07.2020 deri 31.07.2020; E-maili zyrtar i datës 03.08.2020; E-maili zyrtar i datës 11.08.2020; E-maili zyrtar i datës 12.08.2020; E-maili zyrtar i datës 13.08.2020; E-maili

zyrtar i datës 12.08.2020; E-maili zyrtar i datës 18.08.2020; E-maili zyrtar i datës 17.08.2020; E-maili zyrtar i datës 27.08.2020; E-maili zyrtar i datës 28.08.2020; E-maili zyrtar i datës 22.09.2020; Raport statistikor për vizita sipas regjioneve; E-maili zyrtar i datës 22.09.2020; E-maili zyrtar i datës 01.10.2020; E-maili zyrtar i datës 14.10.2020; E-maili zyrtar i datës 29.10.2020; E-maili zyrtar i datës 20.10.2020; E-maili zyrtar i datës 09.11.2020; E-maili zyrtar i datës 06.11.2020; E-maili zyrtar i datës 09.11.2020; E-maili zyrtar i datës 10.11.2020; E-maili zyrtar i datës 30.10.2020; E-maili zyrtar i datës 10.11.2020; E-maili zyrtar i datës 11.11.2020; Emaili zyrtar i datës 30.11.2020; E-maili zyrtar i datës 02.10.2020; E-maili zyrtar i datës 03.12.2020; E-maili zyrtar i datës 21.12.2020; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 23.03.2021, nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 26.03.2021, nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se ka realizuar të gjitha objektivat sipas planit duke bërë edhe tejkalimin e planit, ka konstatuar që ankuesi nga udhëheqësi i tij i drejtpërdrejt është vlerësuar me notën e përgjithshme 2.37, duke konstatuar që nuk ka arritur të përmbush objektivat, mirëpo gjatë shqyrtimit të provave të lëndës respektivisht planit të hyrave për vitin 2020 sipas drejtorive rajonale dhe DTM, shihet që plani për vitin 2020 për Drejtorinë Rajonale ne Prizreni 2, ka tejkalim të planifikimit te të hyrave për këtë drejtori.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në provat e lëndës respektivisht Planit të kontrolleve për vitin 2020, shihet që për regjionin e Prizrenit 2 kanë qenë të planifikuara të realizohen 66 kontrolle, ndërsa janë realizuar 80 ku edhe këtu ka tejkalim të planifikimit për kontrolle për 14 kontrolle mbi planifikim, ndërsa sa i përket planit të vizitave dhe aktiviteteve për vitin 2020 janë planifikuar gjithsejtë 1298 vizita ndërsa janë realizuar 1828 vizita rrjedhimisht kemi tejkalim të planifikimit. Gjithashtu nga të dhënat statistikore të ofruara nga ankuesi, shihet se gjatë vitit 2020 ka pasur rezultate dhe efekte të tatimit shtesë, ku shihet që regjioni Prizreni 2 për periudhën janar-dhjetor ka realizuar tatim shtesë mbi 3.4.milion euro, me pjesëmarrje prej 13.3%, në tatimin e përgjithshëm shtesë të Administratës Tatimore të Kosovës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke marrë parasysh faktin që ankuesi nga pozita „Drejtor i Drejtorisë Rajonale në Ferizaj, është caktuar në pozitën Drejtor i Drejtorisë Rajonale në Prizrenin 2 nga data 03.02.2020, konstaton se ankuesi për muajin janar nuk ka përgjegjësi për këtë drejtori. Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke marr parasysh edhe situatën me pandeminë, konstaton se realizimi i objektivave nga Drejtoria Rajonale në Prizren 2 të cilën nga data 03.02.2020 e udhëheq ankuesi është evidente, ndërsa sa i përket objektivave Rimbursimi dhe Fiskalizimi, nga përgjigja zyrtare përmes emalit të datës 25.04.2021 të dhënë nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të ATK e cila thekson se: *“Për sa i përket objektivave Rimbursimi dhe Fiskalizimi janë nen menaxhimin e Departamenteve tjera”,*

25.04.2021 të dhënë nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të ATK e cila thekson se: *"Për sa i përket objektivave Rimbursimi dhe Fiskalizimi janë nën menaxhimin e Departamenteve tjera"*, rrjedhimisht nga kjo Kolegji konstaton se ankuesi në Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë 2020 është vlerësuar edhe për objektivat 4. Rimbursimi dhe 5. Fiskalizimi, e kjo në kundërshtim me organizimin e brendshëm dhe me përgjegjësit dhe detyrat që i ka ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se tek vlerësimi në bazë të aftësive ankuesi për menaxhim të punëve, motivim, për njohuri profesionale, punë në grup, iniciativë dhe kreativitet, për aftësi komunikuese dhe për efikasitet në punë në vitet paraprake është vlerësuar me nota të larta, ndërsa këtë vit për të njëjtat përgjegjësi është vlerësuar me një rezultat më të dobët.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në faktet dhe në të lartcekurat, konstaton se ankuesi nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe në raport me arritjen e objektivave dhe sjelljeve profesionale siç parashihet me nenin 3 dhe 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë. Po ashtu nuk ka asnjë dëshmi që vlerësuesi pasi që ka përgatitur formularin të jetë takuar me ankuesin në mënyrë që të diskutohet lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë siç parashihet me nenin 8 paragrafin 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, në mënyrë që ankuesi të pajtohet apo jo me vlerësimin.

Duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, vërehet qartë që vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është bërë me datën 08.02.2021 sipas nënshkrimit të vlerësuesit, në këtë rast vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2020, ka qenë obligim të bëhet deri me datën 31 janar 2021 siç parashihet me dispozitat e nenit 43 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 8 paragrafit 2 të Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë.

Bazuar në këto rrethana Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar që udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Operacione pranë Administratës Tatimore të Kosovës, duke marrë parasysh të lartcekurat, detyrohet të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin në pajtim me përkrahimin e detyrave të punës së tij dhe këtë ta bëjë në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.136/2021

Ardita PERÇUKU-SHYTI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAIRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Operacione pranë Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

